b)1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

c)1 (një) punonjës i pajisur me certifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).

- Diplomë/Certifikatë

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e

kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- *“Specialist Ekspert Zjarrfikes”* në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin", Neni 49, pika 4. " Rekomandohet të jete në kantier për minimizimin e aksidenteve në punë.

- *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”* rekomandohet të jete në kantier për trajnimin e punonjesve të kantierit për minimizimin e aksidenteve në punë.

- *“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”* rekomandohet të jete në kantier në rast aksidentesh në punë

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Dëshmi të Sigurimit Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	2
Teknik mekanik	1
Teknik IT/Elektronik	1
Hidraulik	2
Elektricitet	4
Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje	3
Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm	2
Hekurkthyes	2
Karpentier	3
Saldator dhe prerës të metaleve	2
Punonjes i izolimeve (Hidroizolues)	2
Murator/Suvatues	4
Pllakashtrues	2
Specialist gipsi	1
Punonjes për dyer dritare	2
Bojaxhi	1
Eskavatorist	2
Shofer	4
Automakinista	2

2.3.8/1 Për punonjesit eskavatorist/ automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të të bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjesve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.9 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes/materialeve	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
-----	---------------------------------	--------	---

1	Njesi e brendshme F.Coil Dysheme, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.21/6.29 kW, P.u = 552 l/h, Vmed.=460 m ³ /h, F.el=57 W, 1F ~230V ~50 Hz. E kompletuar me pompe kondense, valvol 3-rrugeshe dhe valvola nderprerese,pult komandimi zonal + kabllim.		
2	Njesi e brendshme F.Coil Dysheme, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 4.13/8.34 kW, P.u = 710 l/h, Vmed.=600 m ³ /h, F.el=76 W, 1F ~230V ~50 Hz. E kompletuar me pompe kondense, valvol 3-rrugeshe dhe valvola nderprerese,pult komandimi zonal + kabllim.		
3	Njesi e brendshme F.Coil Kanalor, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.06/6.02 kW, P.u = 526 l/h, Vmed.=487 m ³ /h, F.el=57 W, 1F ~230V ~50 Hz. E kompletuar me pompe kondense, valvol 3-rrugeshe dhe valvola nderprerese,pult komandimi zonal + kabllim.		
4	Njesi e brendshme F.Coil Kanalor, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.37/6.62 kW, P.u = 580 l/h, Vmed.=487 m ³ /h, F.el=57 W, 1F ~230V ~50 Hz. E kompletuar me pompe kondense, valvol 3-rrugeshe dhe valvola nderprerese,pult komandimi zonal + kabllim.		
5	Njesi e brendshme F.Coil Kanalor, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.65/7.22 kW, P.u = 628 l/h, Vmed.=592 m ³ /h, F.el=76 W, 1F ~230V ~50 Hz. E kompletuar me pompe kondense, valvol 3-rrugeshe dhe valvola nderprerese,pult komandimi zonal + kabllim.		
6	Nj. e brendshme Multisplit, ne funksion te Amb.Teknike Elektrike, ftohje 2.1kW, , Vmed.=350/650 m ³ /h, F.el=40 W, 1F ~230V ~50 Hz. me pompe kondense, pult kom. +kabllim, ndezje automatike .Perfshire cdo aksesori te nevojshem per funksionim normal.		
7	Njesi Rikuperimi Ajri. Volumi i Ajrit 1950m ³ /h, Presioni Statik 145 Pa. Fuqia e Ventilatoreve 0.977x2kW, 1F-230V-50Hz Eficensa e rikuperimit Ftohje/ Ngrohje 56.0%/76.3% Kapaciteti I baterise Ftohje/Ngrohje 11.1/23.7kW Prurja e ujit Ftohje/Ngrohje 1.9/2.1 m ³ /h		
8	Njesi Rikuperimi Ajri. Volumi i Ajrit 1400m ³ /h, Presioni Statik 145 Pa. Fuqia e Ventilatoreve		

	0.755x2kW, 1F-230V-50Hz Eficensa e rikuperimit Ftohje/ Ngrohje 54.0%/76.0% Kapaciteti I baterise Ftohje/Ngrohje 8.8/19.7kW Prurja e ujit Ftohje/Ngrohje 1.5/1.7 m3/h		
9	Njesi Rikuperimi Ajri. Volumi i Ajrit 950m3/h, Presioni Statik 125 Pa. Fuqia e Ventilatoreve 0.495x2, 1F-230V-50Hz Eficensa e rikuperimit Ftohje/ Ngrohje 52.1%/75.3% Kapaciteti I baterise Ftohje/Ngrohje 5.0/12.0kW Prurja e ujit Ftohje/Ngrohje 0.9/1.1 m3/h		
10	Rregullator automatik volumor (VAV) - V= 2640 m ³ /h + komand kontrolli, i kompletuar me te gjitha aksesoret per funksionim normal.		
11	Rregullator automatik volumor (VAV) - V= 1980 m ³ /h + komand kontrolli, i kompletuar me te gjitha aksesoret per funksionim normal.		
12	F. Panel reduktimi 2 gaze, + kasete + alarm		
13	F. Panel reduktimi 4 gaze, + kasete + alarm		
14	F. Njesi tavanore anestezie		
15	F. Njesi tavanore kirurgjie		
16	SI. NVR 32, IP Kanale, Up me 32-ch IP hyrje kamerash,		
17	Gjenerator avulli per A.H.U. Sasia e avullit te prodhuar :9-90 kg/h , Presioni min/max i punes 1 -10 bar, Fuqia el. 2x34.2 kW,(400V - 3F~ 50Hz), me panel el. +aksesore.		
18	Gjenerator diesel S = 500 kVA / , Un =400V, silencioze, deri 60db per 7m, komplet me kuadrin automatik te komuntimit te fuqise "Automatic Transfer Switch" dhe gjithcka te nevojshme sipas standartit.		
19	U.P.S. 200 KVA, tension 3 fazor hyrje dhe 3 fazor dalje ,		
20	UPS 40 KVA tension 3 fazor hyrje dhe 3 fazor dalje		
21	Central zjarri, me mundesi komunikimi ne rrjet centralesh npj kartave i adresueshem ,230V /12V, 24 h/aut. 127 elemente per loop (komplet centrali)		
22	Transformator fuqie TM 1000 KVA/20/0.4 Kv, Icc=20KA tipi i thatë, me rezine,uk=6%, lidhjen Dyn5		

23	Cel tranfo, me automat ndares me mikrologjik ne SF6 , 24kV, lcc=20KA, 630A,		
24	Çel Matje energjie, 24KV lcc=20KA In=630A Permasa 750x840(940)x1600mm		
25	Njesi e jashtme pompe nxehtesie , MULTI-SPLIT me 4 dalje type, kompresor inverter, gas pune R410A, 1faze/ 50Hz/ 230V. Kapaciteti 8.0 kW ftohje. Fuqia eletrike 3.8 kW. + Aksesoret e nevojshem per funksionim normal		
26	Central controlling unit [Digital Int. System Manager] EN 54-16 certified and EN 60849 compliant 8 zona dhe me mundesi zgjerimi, 9 hyrje audio, 4 dalje audio, me mundesi komunikimi ne rrjet me centralin e zjarrit etj.		

2.3.9/a Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.9, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

2.3.9/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha pajisjet/materialet sipas pikës 2.3.9. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.

2.3.9/c OE të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka një numër të madh zërash që janë furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventive. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rendesia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që në këtë fazë krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi në këtë mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike të këtyre pajisjeve e cila është lehtësisht e kontrollueshme gjatë fazes së zbatimit në referencë me dokumentat e paraqitura që gjatë kualifikimit. Nepërmjet dorezimit të këtij dokumentacioni që në fazën e vlerësimit asnjë OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjatë zbatimit të furnizojë të njëjtin mall të certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë

dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me qëllim të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës me sipër garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **18 (tetembedhjetë)** muaj kalendarike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/ EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën SSH/EN/UNI **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- e) Certifikatën SSH EN **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të

jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.11 gërma "a"- "e" janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

ISO 9001:2015 / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 / ekuivalente ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 / ekuivalente është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 ose me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018/ ekuivalente është standart ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin

e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

EN-ISO 3834-2:2021 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues që merr persiper punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilesise se ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të cojnë në carje të nyjeve.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.11 gërma “a”- “e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet te disponoje:

Licëse të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe praqjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.13 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion kapaciteti mbajtës min 20 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamion kapaciteti mbajtës 10-20 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamionçine kapaciteti mbajtës min 1.5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Autobot Uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Dumper kantieri	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Fadrome	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Eskavator me zinxhire	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Autobetoniere	copë	3	Në pronësi ose me qera
10	Autopompe betoni / Pompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Mini Fadrome/ Bobcat	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Kamion me vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Rimorkiator / Karrotrec	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Rrul gome-hekur jo me pak se 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Rrul hekur-hekur	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Cekiç Hidraulik	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Elektroorgano	copë	2	Në pronësi ose me qera
19	Vibrator betoni	copë	3	Në pronësi ose me qera
20	Tokmak ngjeshës	copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Pompe uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Pajisje niveluese shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Matrapik	copë	4	Në pronësi ose me qera
24	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera

26	Pompë suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
27	Depozite uji min 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Vinc me kosh	copë	1	Në pronësi ose me qera
29	Makineri për kthim hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
30	Makineri për prerje hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
31	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
32	Autobitumatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
33	Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodë III.1.B)	copë	1	Në pronësi / me qera ose kontratë furnizimi
34	Skela metalike	m2	1000	Në pronësi ose me qera
35	Sharrë me disk	copë	1	Në pronësi ose me qera
36	Kompresor Ajri	copë	2	Në pronësi ose me qera
37	Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
38	Aparat torkretimi	copë	1	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a)** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b)** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).
- c)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standardeve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standardeve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit, relacionet, specifikimet etj. bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qendror blerës nga Autoriteti Kontraktor perfitues(Ministria e Shëndetësisë) dhe të hartuara nga projektuesi.

NJESIA E PROKURIMIT